



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Kryetari i Komunës
01.Nr. 104/02-4403/22
Kaçanik, 15.II.2022

Në mbështetje të buxhetit të komunës si dhe Rregullores të MF - NR – 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Komuna e Kaçanikut bën:

THIRRJE PËR APLIKIM PËR SUBVENCIONE PËR VITIN 2022
Në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - vlera 62.000,00 €

I. KULTURË (Subvencionimet totale në vlerë të 18.500,00 €)

Të drejtë aplikimi kanë të gjitha OJQ-të, Shoqëritë Kulturore- Artistike, Organizatat kulturore të cilat janë të regjistruara në Republikën e Kosovës e që veprojnë në Komunën e Kaçanikut, të cilat janë të dëshmuara për promovimin, ruajtjen dhe kultivimin e vlerave kulturore-tradicionale, gjithnjë duke u bazuar në plan-programin e tyre vjetor për vitin 2022, si dhe në politikat programore të Sektorit të Kulturës për organizimin e festivaleve, koncerteve dhe shënimin e datave kulturore dhe historike, si dhe aktivitete tjera, duke iu përshtatur edhe kushteve dhe rrethanave me pandeminë.

Nr	Drejtuar	Qëllimi	Vlera
1	Organizatave kulturore të regjistruara në DKRS, të cilat merren me ruajtjen, kultivimin dhe promovimin e vlerave kulturore	Subvencionim sipas plan-programit të organizatave	6.500,00€,
2	Organizatave kulturore të regjistruara në DKRS, të cilat merren me kultivimin dhe organizimin e aktiviteteve kulturore	Subvencionim sipas plan-programit të DKRS – Organizimi i Festivalit Kombëtar të SHKA-ve dhe Ansambleve Kuluro-Artistike (3 ditë nga 3 shoqëri/ansamble)	6.000,00€,
3	Organizatave kulturore të regjistruara në DKRS, të cilat merren me kultivimin dhe organizimin e aktiviteteve muzikore e kulturo-artistike	Subvencionim sipas plan-programit të DKRS – Organizimi i Festivalit të Këngës Popullore për Fëmijë “Kaçaniku Këndon”, edicioni i 7-të (organizim 3-ditor)	4.000,00€,
4	Organizatave kulturore të regjistruara në DKRS, të cilat merren me organizimin e aktiviteteve kulturo-artistike	Subvencionim sipas plan-programit të DKRS – Organizimi i aktivitetit për mërgimtarët, me moton: “Ju jeni pjesë e atdheut”	2.000,00€
Totali i subvencioneve në Sektorin e Kulturës			18.500,00 €

II. RINI DHE SPORT (Subvencionimet totale në vlerë 43.500,00 €)

Të drejtë aplikimi kanë të gjitha OJQ-të Rinore, Klubet Sportive Publike, që janë të regjistruara në Republikën e Kosovës e që veprojnë në Komunën e Kaçanikut, të cilat janë të dëshmuara për promovimin e të drejtave të fëmijëve, punën vullnetare, zhvillimin dhe masivizimin e sportit, përkrahjen e klubeve sportive, gjithnjë duke u bazuar në plan-programin e aktiviteteve (garave) të tyre për vitin 2022, si dhe në politikat programore të Sektorit për Rini e Sport – zhvillimin dhe masivizimin e sportit, përkrahjen e klubeve sportive, fuqizimin e rinisë, mbështetjen për organizimin e ngjarjeve promovuese dhe rekreative, si dhe aktiviteteve, duke iu përshtatur edhe kushteve dhe rrethanave me pandeminë.

Kërkesa për aplikim për të gjithë sektorët - Kulturë, Rini dhe Sport, duhet të përmbajë:

- Projekt – Propozimet, që do të dorëzohen bashkë me koston totale vetëm në formularët e paraparë, të cilët, së bashku me udhëzimet për aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të Komunës së Kaçanikut;
- Plotësimi i Formularit për aplikim (shkarko aplikacionin <http://kk.rks-gov.net/kacanik>
Kliko: SHPALLJET --- APLIKACIONET --- FORMULARI PËR APLIKIM - KULTURE, RINI, SPORT)

Kërkesës duhet t'i bashkëngjiten edhe dokumentet :

- Çertifikata e numrit të regjistrimit të organizatës;
- Çertifikata e numrit fiskal të organizatës;
- Vërtetimi i regjistrimit në Drejtorinë e Arsimit dhe Kulturës në Kaçanik, përkatësisht në DKRS;
- Vërtetimi i regjistrimit në Federatën Përkatëse (vetëm për klubet - niveli garues);
- Letërnjoftimi i personave/aplikantit, që përfaqëson organizatën;
- Xhirrollogaria dhe dëshmia e bankës në emër të organizatës;
- Dëshmia se organizata nuk ka obligime ndaj ATK-së;

Dokumentacioni i cili shkarkohet nga ueb-faqja e Komunës : <http://kk.rks-gov.net/kacanik> :

- Formulari i aplikacionit për projekt-programin F-9 (formati në word),
- Formulari i propozim-buxhetit F10 (formati në excel),
- Formulari i deklaratës së partneritetit F11 (formati në word),
- Forma e deklaratës së projekteve të financuara F13 (formati në word),
- Deklarata e përbashkët F14 (formati në word).

Data e aplikimit: nga 15.II.2022 deri më 07.III.2022

Aplikacionet (mbyllur në zarf), dorëzohen në objektin e Komunës së Kaçanikut, në Zyrën e Pritjes (sporteli nr. 5).

Vërejtje:

- Aplikacioni i cili nuk përmban të dhënat e kërkuara dhe dokumentacionin përkatës të kërkuar, nuk do të shqyrtohet.
- OJQ-të duhet të kenë të kryera transaksionet financiare në mënyrë transparente, sipas legjislacionit për OJQ-të, si dhe t'i kenë të përmbyllura të gjitha detyrimet paraprake. Po ashtu, para nënshkrimit të kontratës, OJQ-të duhet të paraqesin prova se personi përgjegjës i OJQ-së dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale.
- Aplikacionet të cilat dorëzohen jashtë afatit të kërkuar, nuk do të shqyrtohen.

Kryetari i Komunës
z. Besim Ilazi

